

FORUMI I ENERGY CHARTER

PAJISEN ME KARTA STUDENTËT E UPT

MIRATOHET PROJEKTI I SHESHIT "SHQIPONJA"

SONDAZHI PËR MIRËMBAJTJEN DHE SIGURINË RRUGORE

INVESTIM I OSHEE NË LUSHNJE

RRJET I RI UJËSJELLËSI NË FUSHË- KRUIJË

"Diversifikimi i Energjisë, Burimeve të Rinovueshme dhe Efiçencës së Energjisë", ishte tema e Forumit të Kartës Ndërkombëtare të Energjisë, që u mbajt në Tiranë. Presidencën e Energy Charter për këtë vit e mban Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndërsa të pranishëm në forum ishin përfaqësues nga të gjitha vendet anëtare. Përmes disa paneleve u trajtuan çështje të cilat lidhen me objektivat e kartës së Energjisë.

Më shumë se 2 mijë studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës janë pajisur me Kartën e Studentit, duke përfutur kështu nga një sërë shërbimesh falas ose me çmime të ulëta. Ministria Balluku dhe kryebashkiaku Veliaj ndoqën nga afër procesin e aplikimit dhe shpërndarjes së kartave. Balluku garantoi se shumë shpejt MIE do të ofrojë shërbime shtesë për të gjithë studentët.

Këshilli Teknik i Autoritetit Rrugor Shqiptar miratoi projektin për sheshin "Shqiponja" në Tiranë, pjesë e projektit të Unazës së Re. Ky projekt i jep zgjidhje përfundimtare trafikut të automjeteve në këtë zonë, shton sipërfaqet e gjelbërta dhe i jep kryeqytetit një hyrje dinnjitoze. Punimet do të zgjasin 24 muaj nga momenti i nisjes së tyre në terren.

Shpejtësia, drejtimi i mjetit nën ndikimin e alkoolit si dhe mungesa e mirëmbajtjes së automjetit janë tre nga faktorët kryesor që çojnë në aksidentet rrugore në Shqipëri. Këto janë të dhënat e sondazhit të zhvilluar në kuadër të Projektit për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë e Rrugëve të bazuar në rezultate, një nismë e ndërmarrë nga MIE së bashku me ARRSH dhe e bashkëfinancuar nga Banka Botërore, i zbatuar nga konsorciumi NTU/Eptisa.

Një investim strategjik i OSHEE në nënstacionin e Plasmasit është drejt përfundimit në qytetin e Lushnjes. Bëhet fjalë për ndërtimin e dy fiderave të rinj 20 kilovolt, shtrirjen prej 40 kilometrash rrjet kabllor ABC si dhe ndërtimin e 23 kabinave të reja. Ky investim siguron furnizim më të mirë me energji elektrike për spitalin e Lushnjes, zonën industriale si dhe do të ketë një impakt në zhvillimin e mëtejshëm të bujqësisë.

Së shpejti 15 mijë banorë të Fushë-Krujës do të kenë 24 orë furnizim me ujë të pijshëm në sajë të investimit të AKUM. Gjithashtu investimi në rrjetin e ujësjellësit do të bëjë të mundur lidhjen e të gjithë konsumatorëve me matësinë, do të eliminojë lidhjet e paligjshme si dhe do të ulë kostot duke mundur rritjen e performancës për UK Krujë.